

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1120 Prot.

Tiranë, më 05.09 2017

VENDIM Nr. 174, datë 05.09.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.11, datë 05.09.2017, pasi shqyrtoi Relacionin e verifikimit në terren në kuadër të projektit "*Rikonstruksioni i garazheve dhe shtesë kati për zyra mbi këtë objekt*"-subjekti Garda e Republikës, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin e verifikimit në terren në kuadër të projektit "*Rikonstruksioni i garazheve dhe shtesë kati për zyra mbi këtë objekt*"-subjekti Garda e Republikës, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Në rast se gjatë zbatimit të punimeve identifikohen gjetje arkeologjike, bazuar në nenin 48 të ligjit 9048, datë 7.4.2003 "Për Trashëgiminë kulturore" (i ndryshuar), subjekti zbatues duhet të ndërpresë menjëherë punimet dhe të njoftojë Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.


KRYETAR
MIRELA RUMBARO FURXHI
MINISTËR

SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

